

DY 100 – VJETORË: MIGJENI NË KËNDVROJTIMIN E PETRO JANURËS

ZEQIRJA NEZIRI

Universiteti 'Shën Cirili dhe Metodi', Fakulteti i Filologjisë 'Blazhe Koneski', Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe, Shkup, Maqedoni
zeqirjaneziri@yahoo.com

AKTET V, 4: 763 - 765, 2012

PERMBLEDHJE

Artikulli prezanton personalitetin e Petro Janurës (1911 – 1983), pedagogut të parë të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Universitetit të Shkupit, si dhe të studiuesit të letërsisë shqipe të viteve '50 – '80 të shekullit të 20 – të. Shkurtime shpesh flitet për disa prej artikujve të tij studimorë më të rëndësishëm për historinë e letërsisë shqipe, duke u ndalur në studimin e tij monografik Migjeni.

Fjalët kyçe: letërsi, monografi, gjuhë, universitet, pedagog, shkrimtar, studiues.

1. Hyrje

Me këtë shkrim dëshirojmë të shënojmë dy 100 vjetorë:

- (1) të lindjes të Petro Janurës, si dhe
- (2) të lindjes së Migjenit.

E kam të vështirë t'i dal në krye artikullit për prezantimin e personalitetit të Petro Janurës, pedagogut të parë të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Universitetit të Shkupit, si dhe të studiuesit të letërsisë shqipe të viteve '50 – '80 të shekullit të 20 – të. Qëndrimi dhe vlerësimi subjektiv, më shumë se kudo tjetër, në raste të këtylla mbetet më i theksuar, sepse velen në sprovë puna dhe veprimtaria e mësuesit nga këndvlerësimi i nxënësit. Sado të përpiqesh të jeshë objektiv në vlerësimin e punës së mësuesit, është e pamundur të zbatohet me përpikmëri ky parim, sepse ndjenja dhe emocioni këtu janë më të pranishme se kudo dhe kurdo herë tjetër.

2. Biografi

Petro Janura i lindur para 100 vjetëve (25 mars 1911) dhe i rritur në Fier, i shkolluar në Rumani dhe Itali, pas LDB, mbeti në Maqedoni dhe, gjithë jetën, u angazhua për emancipimin e shqiptarëve të këtij krahu të kombit, ndihmoi në ruajtjen dhe

kultivimin e kulturës, të gjuhës e të traditës kombëtare midis shqiptarëve të këtyre anëve. Deri më 1983 (30 gusht), kur vdes, është në ballë të përparimit, në mënyrë legale, të çështjes shqiptare. Botoi një varg artikujsh dhe dy vepra të rëndësishme, për kohën, njëra për alfabetin dhe tjetra për Migjenin.

Në Shkup e kaloi pjesën kryesore të jetës dhe aty e zhvilloi, afirmoi dhe e mbylli veprimtarinë publicistike, pedagogjike arsimore dhe intelektuale shkencore, duke punuar rreth 30 vjet mësues e profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe. Është midis kuadrove të rrallë shqiptarë me arsimim të lartë në Maqedoni. Do të punojë si profesor në shkollën e parë të mesme në gjuhën shqipe në Shkup, pastaj në Fakultetin e Filologjisë e në Shkollën e Lartë Pedagogjike. Mbetet themelues i gazetarisë shqiptare në Maqedoni (si drejtor i parë i gazetës 'Flaka e vëllazërimit'), i mendimit shkencor albanologjik në Maqedoni dhe themelues i Katedrës së Gjuhës e të Letërsisë Shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Shkupit, në të cilën punoi prej fillimit të saj si lektorat (1952 – 1966) e seminar (1966 – 1971), mandej katedër (1971) derisa vdiq më 1983.

Përgjatë tri dekadave e gjysmë sa u mor aktivisht me veprimtari të ndryshme shoqërore, publicistike dhe shkencore arriti të botojë një numër të madh artikujsh (rreth 200 sosh) gjuhësorë, kritikë letrarë dhe historikë për vepra dhe autorë të ndryshëm si të traditës e të bashkëkohësisë letrare shqiptare, ashtu edhe të letërsisë së huaj. Ka prekur edhe çështje të letërsisë e të gjuhësisë krahasimtare.

3. Veprimtaria shkencore

Në këtë shënim më tepër me karakter njohës dhe informativ do të përpiqemi të veçojmë vetëm një pjesë të veprimtarisë së tij shumë të pasur edukative mësimore dhe shkencore intelektuale, sidomos veprën monografike *Migjeni* (1982), për të përmbushur kështu një detyrë kurrë të pambaruar të një detyrimi moral që kam për mësuesin, të cilit ndoshta, në këtë mënyrë, do t'ia shperblej borxhin që i detyrohem (si njeri dhe si profesor).

Artikujt e profesor Petro Janurës të botuar në periodikun shqiptar të Maqedonisë janë tre tipëshe:

- (1) informative – publicistike;
- (2) kërkimore shkencore; dhe
- (3) monografike.

(1) Në shkrimet e grupit të parë, në mënyrë informative popullarizuese, bëhet prezantimi i personalitetit të figurave të ndryshme të kulturës së shkruar e të dijës shqiptare, si dhe të letërsisë botërore.

Të kësaj natyre janë shkrimet përgjithësuëse përkushtimore për shkrimtarët shqiptarë (qofshin këto për shënimin e vdekjes, qofshin për shënimin e përvjetorit të lindjes, ose për ta shënuar përvjetorin e botimit të ndonjë veprë të rëndësishme). Këtu radhiten shkrimet për Dora d'Istrian, Zef Seremben, Nolin, Ali Asllanin, Migjenin, Mark Gurakuqin.

(2) Midis shkrimeve të thelluara kërkimore shkencore radhiten studimet për fragmentin e Ungjillit të shën Mateut, Voskopojën, pesë artikuj për Naim Frashërin, Mjedën, Asdrenin (me të cilin kishte pasur miqësi në Bukuresht).

Ndër artikujt e shkencorisht të qëndrueshëm mbesin studimet për dokumentat e parë të

shkrimit të shqipes, veçmas për '*Perikopenë ungjillore*', të cilën në kohë e nxjerr në kontekst të jehonës së Principatës së Arbërit (fundi i shekullit XII) dhe fillimeve të Humanizmit Evropian (fillimshekulli XIII), si vazhdimësi e veprimtarisë iluministe të shqiptarëve të Dubrovnikut, ku më 1284, për herë të parë përmendet gjuha shqipe, si *lingua albanesca*.

Një segment të veçantë paraqesin shkrimet për letërsinë bashkëkohore të kohës, që krijohej në trojet jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Si ithtar i tradicionalizmit aristotelian angazhohet për një letërsi origjinale shqiptare, kërkon që në të të shtjellohen tema të jetës shqiptare, duke nënkuptuar këtu edhe temat e historisë kombëtare. Këto pikëpamje i shtron në disa shkrime teorike për letërsinë shqipe të pjesës së dytë të shekullit të 20 – të, si dhe nga poezia e Martin Camajit, i cili atëherë (në vitet '50 të shekullit të 20 – të) kishte botuar dy përmbledhje vjershesh në Prishtinë.

(3) Si e përmendëm edhe më lart, si kurorëzim i veprimtarisë kërkimore shkencore të profesor Petro Janurës mbesin dy studimet e gjata monografike: *Për historinë e alfabetit shqip* (1969) dhe *Migjeni* (1982) të dyja të botuara në Shkup. Historia e alfabetit përgjithësisht është ndër të parat studime monografike për diakroninë e alfabetit të shqipes.

4. Libri për Migjenin

Libri për Migjenin, ka 326 faqe me shkronja të imta dhe rreshta të dendur. Është i tipit monografik dhe është ndër të parat e këtij lloji në studimet historike letrare shqiptare. Ndahet në katër pjesë, shoqërohet me një introduktë të shkurtër tri faqesh, bibliografi të pasur të veprave të Migjenit e për veprën e tij dhe përfundon me listën e emrave.

Në *pjesën e parë* pas kronologjisë së jetës dhe veprës së Migjenit flitet për momentet jetësore të poetit në shkollën e mesme të Manastirit dhe për gërshetimin e biografisë me veprën e poetit.

Fill pas përkufizimeve të përgjithshme për jetën dhe veprën e poetit të mjerimit, në *pjesën e dytë*, e cila është edhe pjesa më e madhe e studimit, analizohet në tërësi krijimtaria poetike e

Migjenit, si ajo në vargje, ashtu edhe ajo në prozë. Në të trajtohen tema si ndërlidhja e jetës personale të poetit me poezinë, rinia në vjershat e Migjenit dhe gati një të gjashtë e studimit në tërësi përbën shpjegimi i prozës së poetit.

Analiza e prozës së Migjenit, është përmbledhur në nëntitullin 'domethënia e prozës së Migjenit', ku interpretohen sipas metodës pozitiviste sociologjike të gjitha prozat e tij. Në vijim studimi ndahet në tema të caktuara, si 'gruaja në veprën e Migjenit', mandej flet për mitin e Migjenit dhe në fund analizohen satirat.

Pjesa e tretë i është lënë interpretimit të ideve të Migjenit të përcjella përmes krijimtarisë së tij. Aty gjejmë shpjegim ideja filozofike, sociologjike, atdhedashuria, humanizmi dhe internaionalizmi, simboli i punës dhe qëndrimi ndaj religjionit.

Pjesa e katërt është rezervuar për vlerën artistike. Në të flitet për artin dhe veçoritë stilistike, estetikën, metrikën dhe gjuhën poetike të Migjenit. Libri përfundon me bibliografinë, listën alfabetike të emrave dhe përmbajtjen.

Si e thotë edhe në parathënie, në këtë vepër ai ka punuar me ndërprerje një çerek shekulli (25 vjet), që do të thotë se e ka pasur preokupim jetësor. Sa për ilustrim po përmendim se në vitet '50 (1952 – 1957) pat shkruar tre artikuj për jetën e Migjenit në gjimnazin e Manastirit.

Libri ka rëndësi të madhe historike letrare, si u tha më lart, sepse është ndër librat e parë

monografikë për krijimtarinë letrare të Millosh Gjergj Nikollës në përgjithësi, në horizontin shqiptar albanologjik dhe, sidomos të studimit të veprës së tij nga ky krahu i kombit, ku si libri i parë i këtij lloji çeli udhën për studime më të thelluara historike letrare dhe analitike mbi veprën e tij.

4. Përfundim

Petro Janura shkroi në një kohë kur, këtu ndër trojet shqiptare të mbetura jashtë shtetit shqiptar, kishte fort pak njerëz që shkruanin për gjuhën shqipe, që rrihnin probleme të gjuhës së përbashkët kombëtare, kur shkruhej shumë pak për kritikën letrare dhe kur për gjithçka që shkruhej duhej pasur kujdes të mos bëhesh viktimë e cenzurës ideologjike.

Në shkrimet historike letrare mbetet i thhtar i metodës pozitiviste, dega e saj sociologjike, në të cilën qe formuar si intelektual. Në një numër artikujsh trajtoi probleme të gjuhës e të letërsisë shqipe, të historisë e të jetës materiale (dokeve e zakoneve) të popullit shqiptar. Puna tridhjetëvjeçare e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Universitetin e Shkupit, si dhe veprimtaria e gjerë publicistike e shkencore flet njëkohësisht edhe për punën e tij të palodhshme, përkushtimin e madh njerëzor e shkencor dhe përgjegjësinë e tij intelektuale.